



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar

Nr. 3083 / Prot.

23

Tiranë, më 10.6. 2013



MIRATOHET

MINISTRI

Myqerem Tafaj
MYQEREM TAFAJ

KURRIKULA KOMBËTARE E ARSIMIT BAZË

PROGRAMI LËNDOR

LËNDA: GJEOGRAFI

Klasa: 7-9

Tiranë, 2013

Grupi i punës:

Prof. Mahir HOTI



Evis MASTORI



Albana KOSOVRASTI



Majlinda ZIU



Albana MARKJA



Silvana AVDULAJ



1. TË PËRGJITHSHME

Programi i lëndës së Gjeografisë për klasat 7-9 është një dokument zyrtar, pjesë e paketës së dokumenteve zyrtare për arsimin bazë. Ky program është mbështetur në Kornizën Kurrikulare të Arsimit Parauniversitar, si dhe në Standardet e të Nxënimit të Fushës së Shkencave Shoqërore.

Zbatimi i programit duhet të bëhet duke respektuar parimet e barazisë gjinore, etnike, kulturore, racore dhe fetare.

Lënda e Gjeografisë në klasat 7-9 të arsimit bazë, ka në fokusin e saj të studimit mjedisin gjeografik me karakteristikat e tij fizike dhe humane, marrëdhëniet e ndërsjella midis shoqërisë dhe komponentëve fizikë të Tokës, në kontekstin e vendit, hapësirës dhe mjedisit.

Në objektin e studimit të kësaj lënde, modelet dhe proceset e mjedisit fizik dhe human të rajoneve të veçanta të hapësirës shqiptare ose të botës në tërësi, shihen në lidhje të ndërsjellë. Gjeografia nxit pyetjet rreth botës natyrore dhe humane, ajo zhvillon njohuritë për vendet dhe mjediset në botë, kuptimin për hartat, si dhe një sërë aftësish hulumtuese dhe të zgjidhjes së problemit, brenda dhe jashtë klasës. Gjeografia është një urë lidhëse ndërmjet shkencave natyrore dhe shoqërore.

Kurrikula e lëndës së Gjeografisë për klasat 7-9 të arsimit bazë ka për mision të kontribuojë në përgatitjen e qytetarëve të ardhshëm për një shoqëri demokratike të zhvilluar, të lirë e të pavarur, të ndërgjegjshëm e me shpirt kritik, të aftë për të bashkëjetuar me mjedisin e tyre dhe për ta ndryshuar atë në mënyrë krijuese duke vështruar nga e ardhmja.

Lënda e Gjeografisë nis të zhvillohet si lëndë më vete pas trajtimit të njohurive dhe aftësive të integruara gjeografike në klasat 1-6. Ky program, i cili do të shtrihet në klasat 7-9, përmban disa risi themelore, të cilat luajnë një rol të rëndësishëm në formimin e nxënësve me njohuri, aftësi dhe qëndrime që i përgatisin ata për të përmbushur studimet e mëtejshme, si dhe për të nxënë gjatë gjithë jetës.

Programi i Gjeografisë për klasat 7-9 përmban një ngarkesë konceptuale më të lehtësuar krahasuar me programet e mëparshme. Përmes tij, nxënësit marrin njohuritë më të domosdoshme për rajonet dhe nënrajonet gjeografike, duke zhvilluar aftësitë e tyre kërkuese dhe përpunuese për t'i zgjeruar më tej këto njohuri.

Një tjetër risi që përcjell programi i gjeografisë për klasat 7-9 është ndryshimi i raportit ndërmjet njohurive të reja dhe përpunimit të tyre. Ky program i krijon më shumë hapësirë përvetësimit të koncepteve të reja, si dhe zhvillimit të aftësive përmes rritjes së numrit të orëve për përpunimin e njohurive (rreth 30-40% të totalit të orëve mësimore për secilën klasë).

Programi i Gjeografisë është ndërtuar duke marrë në konsideratë veçoritë konjitive, psikologjike e sociale të nxënësve. Ai është hartuar sipas strukturave bashkëkohore të planifikimit dhe programimit kurrikular. Përmbajtja e tij, e organizuar dhe e shprehur përmes gjuhës së objektivave, rrit shkallën e fleksibilitetit të programit, duke i ndihmuar dhe duke u lënë dorë më të lirë përdoruesve të tij (mësuesve, autorëve të teksteve, prindërve, specialistëve etj.), për ta zbatuar atë në mënyrë krijuese.

1.1. Përdoruesit e programit

Programi i lëndës së Gjeografisë për arsimin bazë u drejtohet në radhë të parë mësuesve të kësaj lënde, të cilët do ta zbatojnë atë në mësimdhënie. Gjithashtu, programi iu drejtohet autorëve të teksteve, të cilët përmes realizimit të objektivave mësimorë të programit në tekstet e tyre, janë një faktor i rëndësishëm progresi në mësimdhënien e lëndës së Gjeografisë.

Ky program është, gjithashtu, në dispozicion të specialistëve të të gjitha fushave, të drejtuesve të shkollave, si dhe për të gjithë aktorët e interesuar për mbarëvajtjen e mësimdhënies në arsimin bazë.

1.2. Organizimi dhe struktura e programit

Programi i lëndës së Gjeografisë për klasat 7-9 të arsimit bazë është ndërtuar mbi bazën e pesë linjave kryesore:

- sistemet fizike;
- sistemet humane;
- vendet dhe rajonet;
- ndërveprimi njeri/mjedis;
- mjetet gjeografike dhe vendndodhja.

Për secilën linjë në programet respektive sipas klasave përcaktohen numri i orëve dhe përmbajtja e shprehur përmes objektivave të të nxënësve. Përcaktimi i termave kyç i orienton përdoruesit e programit në organizimin e përmbajtjes.

Lënda e Gjeografisë në arsimin bazë do të studiohet si lëndë më vete me 2 orë javore në secilën nga klasat 7, 8, 9; gjithsej në 210 orë mësimore.

Përmbajtja e kurrikulës së Gjeografisë për klasat 7-9 është organizuar si më poshtë:

Në **klasën e 7-të**, përmbajtja e lëndës do të përqendrohet kryesisht në njohjen e shkencës së gjeografisë, marrëdhënien e saj me disiplinat e tjera të dijes, kuptimin dhe përdorimin e koncepteve bazë të kërkimit gjeografik, kuptimin për hartat dhe përdorimin e tyre, strukturën dhe dinamikën e komponentëve të gjeosistemit, marrëdhëniet ndërvepruese ndërmjet tyre, si dhe ndërveprimin me veprimtarinë njerëzore. Lënda i njeh nxënësit me konceptet themelore që lidhen me karrierën në Gjeografi. Kjo është një mundësi e mirë që nxënësit të zgjerojnë kuptimin e tyre për karrierën në këtë fushë.

Në **klasën e 8-të**, lënda e Gjeografisë ka për objekt studimi gjeografinë rajonale të botës. Kjo lëndë u krijon nxënësve mundësinë të kuptojnë marrëdhëniet komplekse që ekzistojnë ndërmjet mjedisve fizike e humane të rajoneve të ndryshme. Lënda ka për qëllim të evidentojë jo vetëm njohuritë mbi kushtet natyrore të rajoneve të ndryshme, karakteristikat shoqërore dhe ekonomike, por edhe kushtet e ndryshme të jetesës së njerëzve në shkallë vendi, rajoni dhe globi.

Në programin e kësaj lënde jepen njohuritë më të domosdoshme për rajonet dhe nënrajonet gjeografike të botës. Përmes studimit rajonal, synohet që nxënësit të kuptojnë shpërndarjen hapësinore dhe të kërkojnë shpjegime për modelet dhe marrëdhëniet midis tyre. Përmbajtja e programit përcjell parimin se puna për formimin e këndvështrimeve holistike për botën që na rrethon, ku konceptet dhe faktet qendrore janë të gërshetuara në kontekste më të mëdha, është thelbësore për formimin gjeografik të nxënësve.

Në **klasën e 9-të**, trajtohen të gjitha trevat shqiptare: Republika e Shqipërisë, Republika e Kosovës, trevat shqiptare në Serbi, Maqedoni, Mal të Zi dhe Greqi, nga pikëpamja rajonale. Këto rajone trajtohen në mënyrë komplekse, duke analizuar të gjitha problemet gjeografike (fizike, sociale, ekonomike, kulturore e mjedisore). Kjo mënyrë e trajtimit të përmbajtjes jep mundësi që të formohen koncepte të qarta shkencore për veçoritë gjeografike të natyrës, shoqërisë dhe ekonomisë; për bashkëveprimin e tyre; për rolin dhe veprimin e faktorëve natyrorë dhe social-

ekonomikë në përcaktimin e fizionomisë së peizazhit gjeografik të trevave shqiptare; për vlerat dhe pasuritë e këtij peizazhi; për perspektivën e zhvillimit të shoqërisë shqiptare etj.

2. SYNIMET E LËNDËS

Programi i lëndës së Gjeografisë për klasat 7-9 synon që nxënësit:

- të fitojnë njohuri për modelet hapësinore, kohore dhe strukturore të dukurive gjeografike, si në mjedisin fizik dhe human, dhe të kuptojnë që këto modele ndryshojnë me kalimin e kohës;
- të fitojnë njohuri mbi kompleksitetin natyror e human të rajoneve e nënrajoneve të ndryshme të botës;
- të zhvillojnë, përmes studimit të gjeografisë kombëtare, aftësitë qytetare, të cilat kontribuojnë në rritjen e tyre si individë, në përgatitjen e tyre për jetën, punën dhe shoqërinë;
- të rritin shkallën e përgjegjësisë për kujdesin ndaj mjedisit përmes zhvillimit të aftësive vendimmarrëse rreth çështjeve që lidhen me shoqërinë dhe mjedisin;
- të aftësohen për të kontribuar në debate mbi zhvillimin e qëndrueshëm si qytetarë të informuar dhe të përgjegjshëm;
- të vlerësojnë lidhjet dhe marrëdhëniet ekonomike, kulturore dhe mjedisore ndërmjet trevave shqiptare dhe vendeve ku ato ndodhen, me Bashkimin Evropian dhe vende të tjera të botës;
- të zhvillojnë aftësitë e nevojshme për të realizuar kërkimin gjeografik, punën me hartën dhe punën në terren;
- të përdorin teknologjinë e komunikimit dhe informacionit për gjetjen, përpunimin dhe prezantimin e informacionit;
- të demonstrojnë qëndrime e sjellje etiko-sociale në punë individuale e në grup.

3. KËRKESA PËR ZBATIMIN E PROGRAMEVE

Programi i lëndës së Gjeografisë për klasat 7-9 përbën një dokument zyrtar, pjesë e tërësisë së dokumenteve zyrtare për lëndën e gjeografisë. Dokumente të tjera kryesore janë Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar dhe Standardet e Fushës Kurrikulare, ku kjo lëndë bën pjesë. Hartimi i programit është mbështetur si te korniza kurrikulare, ashtu dhe te standardet e fushës. Për të siguruar përdorimin sa më të mirë të programit, është e vlefshme njohja me dokumentet e lartpërmendura.

Në funksion të zbatimit sa më me cilësi të programeve janë edhe materialet udhëzuese të Institutit të Zhvillimit të Arsimit.

3.1. Objektivat e programit

Objektivat e programit janë për të gjithë nxënësit dhe janë detyrim për përdoruesit e programit. Kjo do të thotë se të gjithë nxënësve duhet t'u jepet mundësia të nxënë çka përshkruhet tek objektivat.

Një objektiv përmbushet në nivele të ndryshme nga nxënës të ndryshëm. Mësuesit dhe autorët e materialeve mësimore duhet të mbulojnë të gjithë gamën e niveleve të nxënësve.

Objektivat mësimorë të programeve përshkruajnë përmbajtjet mësimore (njohuritë, aftësitë, qëndrimet), që do të përvetësohen nga nxënësit në linjën dhe nënlinjën e dhënë ose në grupin tematik të përmbajtjes.

- Përmes një objektivi, informohemi për *përmbajtjen mësimore* që nxënësi duhet të përvetësojë. P.sh., në objektivin: “*Nxënësit përshkruajnë formën e Tokës, përmasat e saj dhe rëndësinë e tyre*”, kuptojmë që në mësim duhet të trajtohet forma e Tokës, përmasat e saj dhe rëndësia e tyre.
- Një objektiv jep, gjithashtu, informacion për *metodën mësimore*. Për shembull, në objektivin në vijim: “*Nxënësit diskutojnë shkaqet e ndotjes së ajrit*”, mësuesi kupton që në zhvillimin e përmbajtjes mësimore për shkaqet e ndotjes së ajrit, do të zbatohet metodën e diskutimit.

- Objektivi informon dhe në drejtim të *planifikimit të vlerësimit të nxënies*. Le ta zbërthejmë këtë në shembullin e objektivit: “*Nxënësit tregojnë në hartë rajonet me dendësinë më të madhe dhe më të vogël të popullsisë*”. Ky objektivi na detyron që arrijmë e nxënësit ta vlerësojmë jo me shkrim, por duke i caktuar një detyrë në hartë, përmes së cilës ai të tregojë rajonet me dendësinë më të madhe dhe më të vogël të popullsisë.

Vendosja e objektivave mësimorë në themel të kurrikulës së Gjeografisë unifikon dhe objektivizon kërkesën për arrijtjet e nxënësve, duke krijuar hapësira për përdorim të larmishëm të burimeve të të nxënësve në trajtimin e përmbajtjeve mësimore.

3.2. Orët mësimore

Programi i lëndës së Gjeografisë për klasën e 7-të, të 8-të dhe të 9-të, është strukturuar në linja dhe nënlinja (blloqe tematike), që vijnë njëra pas tjetrës. Realizimi i objektivave në tema, kapituj, njësi dhe renditja e tyre është zgjedhje e lirë e zbatuesve të programit.

Sasia e orëve mësimore për secilën linjë është rekomanduese. Zbatuesit e programit janë të lirë të ndryshojnë me 10% (shtesë ose pakësim) orët e rekomanduara për secilën linjë. Ata duhet të respektojnë sasinë e orëve vjetore të lëndës. Mësuesi mund të vendosë të përparojë më ngadalë kur vë re se nxënësit e tij hasin vështirësi të veçanta në përmbushjen e objektivave të kapitullit, por mund të ecë më shpejt kur nxënësit demonstrojnë një përvetësim të kënaqshëm.

Programi i Gjeografisë për **klasën e 7-të, klasën e 8-të dhe klasën e 9-të** zhvillohet në **70 orë mësimore vjetore/secila klasë** (210 orë mësimorë në tri vite), prej të cilave **60-70% njohuri të reja**, kundrejt **30-40% përpunim i njohurive**. Në ndryshim nga programet e mëparshme, numri i orëve, i parashikuar për rubrikën “Orët e lira”, përfshihet në numrin e orëve të planifikuara për rubrikën “Përpunimi i njohurive”.

3.3. Përpunimi i njohurive

Përpunimi i njohurive përmban:

- *Punët praktike*, të cilat përbëjnë një pjesë integrale të kësaj lënde. Ato krijojnë mundësi për zbatimin e përvojave të të nxënësve në këtë lëndë. Punët praktike janë ilustrim praktik i

njohurive të fituara nga nxënësit, por njëkohësisht ato i shërbejnë dhe zhvillimit të një sërë aftësive që kanë të bëjnë me mbledhjen, përpunimin dhe interpretimin e të dhënave.

- *Përsëritjen brenda një kapitulli të njohurive bazë të tij (konceptet themelore).*
- *Testimin e njohurive bazë.*
- *Integrimin e njohurive të reja të një kapitulli me njohuritë e kapitujve paraardhës.*
- *Integrimin e njohurive të reja me njohuritë e lëndëve të tjera (ndonëse këto integritime do të përshkojnë zhvillimin e çdo ore mësimore, gjatë përpunimit i duhet kushtuar kohë e posaçme).*
- *Projektin kurrikular lëndor.*
- *Përsëritjen vjetore (pavarësisht nga ndarja në linja ose në kapituj, lënda duhet parë si një e tërë).*
- *Testimin vjetor (nuk është i detyruar).*

Veçanërisht gjatë përpunimit të njohurive duhet t'i kushtohet kohë e posaçme kultivimit të:

- aftësive të përgjithshme, si: aftësia e komunikimit, e menaxhimit të informacionit, e zgjidhjeve problemore, e të menduarit kritik dhe krijues;
- aftësive të posaçme lëndore, që zhvillohen përmes punës me hartën, punës me të dhënat statistikore, grafikët etj.;
- formimit të qëndrimeve, si qëndrimi etiko-social dhe gjatë punës në grupe të vogla nxënësish.

Pjesë e përpunimit të njohurive është rishqyrtimi vjetor, i cili ka për qëllim të nxjerrë në pah dhe të përforcojë konceptet e metodat themelore të kësaj lënde. Rishqyrtimi mund të bëhet me anën e një projekti, detyre tematike me karakter individual ose grupi etj.

4. INTEGRIMI DHE LIDHJA NDËRLËNDORE

Përdoruesit kryesorë të programit të lëndës së Gjeografisë duhet të përpiqen ose të kenë prirjen për të mbajtur parasysh mundësitë e lidhjes së kësaj lënde me lëndët e tjera.

4.1. Integrimi dhe lidhjet brenda fushës kurrikulare

Gjeografia dhe Historia

Lënda e *Gjeografisë* dhe e *Historisë* kanë të përbashkët një sërë konceptesh. Lidhjet e Gjeografisë me Historinë janë të ngushta për faktin se veçoritë e sotme të gjeografisë së popullsisë dhe të ekonomisë në mjaft raste, nuk mund të kuptohen pa njohur të kaluarën historike të rajoneve ose vendeve të ndryshme. Po kështu, lidhja e gjeografisë kombëtare me historinë kombëtare përmban vlera të konsiderueshme në realizimin e programit të Gjeografisë së Shqipërisë dhe trevave të tjera shqiptare.

Gjeografia dhe Qytetaria

Lënda e *Gjeografisë* dhe ajo e *Qytetarisë* kanë të përbashkët një sërë konceptesh, si p.sh.: mjedis, rend ekonomiko-shoqëror, marrëdhënie njeri-mjedis, marrëdhënie ndërshtetërore, globalizëm, përfaqësimi, liria etj., por edhe një sërë aftësish, si: përshkrimi, analiza, shpjegimi, diskutimi, kërkimi, interpretimi etj. Gjeografia u jep aktualitet më të madh çështjeve me të cilat merret edukata, si dhe ndihmon në debate për çështje dhe ngjarje të rëndësishme.

Lidhjet brenda lëndore të Gjeografisë duhen parë edhe në aspektin e vazhdimësisë dhe koherencës midis programit të Gjeografisë së klasave 7, 8 dhe 9. Konceptet bazë të gjeografisë fizike ose ato që lidhen me rajonizimin (ç’është rajoni, kriteret e klasifikimit të rajoneve etj.), të trajtuara në klasën e 7-të dhe të 8-të janë të rëndësishme për të kuptuar dhe trajtuar ndarjen rajonale gjeografike të territorit të Republikës së Shqipërisë, si dhe të trevave të tjera shqiptare.

4.2. Integrimi dhe lidhjet me fushat e tjera kurrikulare

Përveç lidhjes dhe integritit të Gjeografisë me lëndët brenda fushës, si element i domosdoshëm për ta parë dhe studiuar botën në mënyrë globale, gjeografia përmban edhe njohuri dhe aftësi që i zhvillojnë lëndët e tjera jashtë fushës së shkencave shoqërore. Mësuesi duhet të jetë i mirinformuar paraprakisht, pasi ai/ajo ndihmohet për strukturimin e mësimdhënies dhe arrijen e objektivave mësimorë të programit të Gjeografisë.

Gjeografia dhe Shkenca natyrore

Gjeografia përbën një urë lidhëse midis shkencave natyrore dhe shoqërore. Njohuritë, aftësitë, qëndrimet në lëndën e Gjeografisë, në mënyrë të veçantë në fushën e gjeografisë fizike, kanë mundësi të shumta lidhje dhe integrimi me ato të disiplinave të shkencave të natyrës. Kështu, për shembull, nxënësit përdorin konceptet bazë të Kimisë kur studiojnë shkëmbinj të dhe mineralet; konceptet e Fizikës kur studiojnë lëvizjet e Tokës; të Biologjisë kur studiojnë historinë e Tokës dhe mjedisin etj.

Gjeografia dhe Gjuha shqipe

Gjuha është themelore për të nxënit e nxënësve në lëndën e Gjeografisë. Nxënësit përziejdhin strategjitë e përshtatshme gjuhësore dhe proceset për të eksploruar, prezantuar dhe komunikuar të kuptuarin e tyre shkencor. Me lëndën e *Gjuhës shqipe* integrohen njohuritë dhe aftësitë që kanë të bëjnë me hartimin e eseve, gjetjen dhe shfrytëzimin e materialeve mediatike, të shkruarin, të lexuarin dhe komunikimin e informacioneve të Gjeografisë. Aftësitë e analizave kritike dhe logjike dhe të menduarit reflektiv rreth ideve shkencore mbështeten në përdorimin e fjalorit gjeografik.

Shembull: Në programin e Gjeografisë së klasës së 9-të, nxënësit përgatisin një ese argumentuese përmes së cilës vlerësojnë problemet aktuale dhe të ardhmen e zhvillimit ekonomik të Republikës së Shqipërisë në kushtet e integritetit rajonal e evropian. Kjo kërkon që ata më parë të kenë njohuri mbi mënyrën e përgatitjes së një eseje dhe për llojet e ndryshme të saj.

Gjeografia dhe Matematika

Në Gjeografi, nxënësit zbatojnë Matematikën përmes përdorimit të numrave, masave, gjatësisë dhe kohës, interpretimit të të dhënave, ndërtimit të grafikëve, përdorimit të simboleve dhe tabelave për prezantimin e informacionit.

Shembull: Ushtrime për përcaktimin e shkallës së hartës apo analiza e grafikëve të elementeve klimatike dhe hidrografike. Kjo kërkon që nxënësit të përdorin njohuritë e marra në Matematikë mbi veprimet me thyesa, ndërtimin e grafikëve etj.

Gjeografia dhe Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit

Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit (TIK) mbështet të mësuarit e lëndës së Gjeografisë në realizimin e detyrave të ndryshme, projekteve, kërkimit, përpunimit dhe prezantimit të informacionit.

Nxënësit kërkojnë në internet informacion (për shembull, për veçoritë fiziko-gjeografike të shteteve të një rajoni të caktuar), harta (fizike, ekonomike, turistike etj.), imazhe satelitore. Ata mund të përdorin Word-Processor-in në shkrimin e materialeve dhe punëve praktike në lëndën e Gjeografisë, zbatojnë hedhjen e të dhënave në tabelë për ndërtimin e grafikëve, përdorin PowerPoint-in për prezantimin e një raporti, materiali informues, projekti kërkimor përmes paraqitjes në slide.

5. METODOLOGJITË E MËSIMDHËNIES

Përdorimi i një numri të madh rrugësh dhe metodash në mësimin e Gjeografisë nga mësuesit është një përbërës thelbësor në procesin e zbatimit me sukses të kurrikulës së Gjeografisë.

Metodat dhe teknikat e të mësuarit shikohen jo vetëm si një proces didaktik, që pasurohen gjithnjë me elemente të reja, por edhe që duhet të zbatohen në mënyrë krijuese. Gjatë orëve të ndryshme të mësimin, metodat dhe teknikat ndërthuren me njëra-tjetrën, aq sa shpesh nuk mund t'i dallosh kufijtë midis tyre. Kështu ndodh me *shpjegimin dhe bisedën, me metodën problemore e kërkimore, stuhinë e mendimit, hartën e mendimit, lojën dhe konkursin gjeografik etj.* Prandaj, vëmendja e veçantë e mësuesit/es duhet drejtuar te lidhja organike e metodave dhe teknikave të veçanta që ai përdor brenda një ore mësimi.

Format, metodat, strategjitë dhe teknikat e të mësuarit duhet të jenë të shumta e të larmishme. Ato zgjidhen në përshtatje me përmbajtjen lëndore, por edhe me nivelin e nxënësve, gjendjen e bazës didaktike etj.

Vlera të mëdha për formimin e koncepteve të drejta gjeografike kanë *vëzhgimet në terren*, pasi në këtë mënyrë realizohet lidhja e koncepteve abstrakte me objektet gjeografike të vrojtuar. Sa më të shumta të jenë vëzhgimet në terren, aq më të pasura e më të qëndrueshme do të jenë përfytyrimet që krijohen. Kështu, në klasën e 7-të mund të organizohen ekskursione në natyrë për studimin e formave të ndryshme të relievit, për lumenjtë, për luginën e një lumi, për veprimin

e erozionit etj. Në klasën e 8-të, kur studiohet gjeografia e Shqipërisë dhe trevave të tjera shqiptare, nxënësit mund të kryejnë vërtetime të relievit në krahinën e tyre, të shpërndarjes së popullsisë etj.

Diskutimi është një nga metodat më të thjeshta, që përdoret në realizimin e veprimtarive në klasë, kur është fjala për të mundësuar procesin e pjesëmarrjes sa më të gjerë të nxënësve në mësim. Diskutimi është një ndërthurje e shpjegimeve mësues-nxënës, e shkëmbimit të pikëpamjeve dhe pyetjeve ndërmjet tyre.

Diskutimi me të gjithë klasën është një mënyrë shumë e mirë për mësuesin/en dhe për nxënësit për të zbuluar se cilat janë qëndrimet e tyre rreth çështjeve, fenomeneve dhe koncepteve të ndryshme që trajtohen në lëndën e Gjeografisë. Gjithashtu, diskutimi është një metodë shumë e mirë për të praktikuar të dëgjuarit të nxënësit, të folurën me radhë dhe aftësi të tjera që nevojiten në punën në grup.

Mjaft rezultate janë edhe metodat që përfshihen në spektrin e metodave *problemore, gjysmëkërkimore dhe kërkimore, si: mësimi zbulues, projekti mësimor etj.* Këto metoda mund të përdoren në ato raste kur nxënësit, në mënyrë individuale ose të organizuar në grupe, ndërmarrin, me ndihmën dhe drejtimin e mësuesit/es, veprimtari që synojnë zgjidhjen e problemeve të thjeshta etj.

Projektet kurrikulare janë modele të veprimtarisë mësimore, realizimi i të cilëve kërkon zbatimin e më shumë se një metode dhe teknike, si: intervista, vërtetimi, studimi i rastit, ndërthurjen e të gjitha këtyre teknikave së bashku.

5.1. Mjetet mësimore

Përdorimi i mjeteve mësimore në mësimdhënien dhe procesin e të nxënësve në lëndën e Gjeografisë ndihmon në konkretizimin e ideve dhe dukurive, në aplikimin e metodave dhe strategjive të mësimdhënies, si dhe e bëjnë mësimin më interesant dhe më rezultativ për nxënësit. Mjetet që përdoren në lëndën e Gjeografisë, janë të llojeve të ndryshme, sepse Gjeografia është një shkencë me objekt mjaft të gjerë studimi. Mjetet mësimore mund të jenë:

- **Mjete të shtypura**, si: hartat (fizike, ekonomike, administrative etj.), atlaset, albumet, tablotë, fotografitë, skicat, diagramët, vjetarët statistikorë, manuallet e të dhënave të elementeve klimatike, hidrografike, floristike, zoologjike, demografike etj.

- **Mjete audiovizuale**, kompjuter, aparat projeksioni, CD, DVD, aparat fotografik etj. Këto mjete po zënë gjithnjë e më shumë vendin që u takon për konkretizimin e një sërë dukurish gjeografike, të cilat janë vështirë të kuptohen pa një konkretizim audioviziv.
- **Objektet natyrore** janë mjete shumë efektive për të konkretizuar njohuritë e lëndës së Gjeografisë. Në këtë grup futen koleksionet e ndryshme që krijohen me material të mbledhur nga natyra, si: gurë, minerale, drurë ose produkte industriale, bujqësore etj.

6. METODAT E VLERËSIMIT TË ARRITJEVE

Vlerësimi i nivelit dhe i cilësisë së arritjes së objektivave mësimorë nga nxënësit është element i rëndësishëm i procesit të të mësuarit të Gjeografisë. Kjo lëndë për vetë natyrën e gjerë të përmbajtjes së saj dhe karakterin e saj ndërdisiplinor, mundëson shumë forma vlerësimi. Verifikimi i shkallës së përgatitjes së nxënësve duhet bërë përmes përdorimit të burimeve të ndryshme të njohurive, si: hartat, grafikët, skicat etj.

Realizimi i përshkallëzuar i programit kërkon përzgjedhjen e formave dhe teknikave bashkëkohore të vlerësimit për të kontrolluar shkallën e përvetësimit të dijeve të nxënësve.

Vlerësimi mbështetet tërësisht në objektivat e programit lëndor dhe mësuesi nuk ka të drejtë të vlerësojë nxënësit për ata objektiva të arritjes që nuk përshkruhen në program. Objektivat e vlerësimit nuk janë vetëm njohuritë dhe aftësitë, por edhe qëndrimet e nxënësve, si qëndrimet etiko-sociale në përgjithësi dhe ato të bashkëpunimit me të tjerët në veçanti. Mësuesi zhvillon vetë dhe ndihmon nxënësit të zhvillojnë një larmi mënyrash vlerësimi.

Metodat e organizimit të vlerësimit në këtë lëndë mund të jenë:

- **vlerësimi individual** (i një nxënësi me gojë ose me shkrim);
- **vlerësimi në grup** (grupi me nga 5-6 nxënës, më shumë ose më pak, kur nxënësi/ja realizon një projekt ose detyrë kërkimore);
- **vlerësimi i të gjithë klasës;**
- **vlerësimi i një detyre**, për të cilën është arritur një marrëveshje midis mësuesit/es dhe nxënësve (p.sh., nëse plotëson pa gabime hartën skicë të Evropës, vlerësohesh me notë maksimale);

- **vlerësimi në çift ose vetëvlerësimi** (p.sh., shoku i bankës vlerëson detyrën ose përgjigjen e shokut dhe anasjellas, ose nxënësi vlerëson veten për realizimin e detyrës, përgjigjes ose testit);
- **vlerësimi i portofolit (dosjes) të nxënësit** (domethënë, i një grupi detyrash të pavarura, të kryera dhe të mbajtura shënim nga ai).

Për nga periodiciteti, vlerësimi i nxënësve mund të jetë:

- **sistematik**;
- **periodik** (në përfundim të çdo kapitulli);
- **semestral dhe vjetor**.

Ai mund të jetë përmbledhës ose formativ, i planifikuar që në fillim të vitit ose i rastësishëm, në varësi të problemeve në procesin e mësimdhënies dhe të nxënësve. Vlerësimi mund të jetë gojor, me shkrim ose i ndërthurur. Këto forma vlerësimi duhet t'u krijojnë mundësi të gjithë nxënësve të vlerësohen në atë mënyrë që është më e përshtatshme për to.

Vlerësimi me gojë, përveç kontrollit të përvetësimit të njohurive, i shërben zhvillimit të disa aftësive të domosdoshme për jetën, si aftësia e të shprehurit, të komunikuarit para një auditori etj. Kjo lëndë nuk e kushtëzon mësuesin të jetë strikt në vlerësimin e nxënësve në çdo orë mësimi, por i krijon mundësi mësuesit ta vlerësojë nxënësin në vijueshmëri, në ecurinë e tij. Kjo mënyrë e të vlerësuarit të nxënësit me gojë në disa orë mësimi, i ndihmon ata të çlirohen nga emocionet dhe bën që mësuesi ta vlerësojë drejt dhe saktë për njohuritë që kanë marrë.

Vlerësimi me shkrim përfshin një mori formash, të cilat në një masë të konsiderueshme janë specifike për secilën lëndë. Ai mund të realizohet nëpërmjet teknikave të ndryshme, si: *veprimtarisë praktike, testimi, eseve, projekteve* etj. Njohja dhe vlerësimi i njohurive të fituara nga nxënësit plotësohet më tej edhe nga shënimet e vetë mësuesit. Mësuesi duhet t'i japë sistematikisht mundësinë çdo nxënësi që të vlerësohet për parashtrimet e tij me shkrim, madje të vlerësohet duke shërbyer si një nxitës për t'i aftësuar më tej në komunikimin me shkrim. Vetë komunikimi me shkrim shkon përtej kufirit tradicional “me letër dhe me stilolaps” dhe përfshin parashtrimet në trajtë elektronike.

Meqenëse kjo lëndë parashikon detyra e projekte, të cilat synojnë, përveç të tjerave, zhvillimin e aftësive të komunikimit e bashkëpunimit, pjesë e vlerësimit të këtyre detyrave janë edhe prezantimet. Prezantimet mund të demonstrohen në forma nga më të ndryshmet, në varësi

të tematikës. Ato mund të përdoren për vlerësim përmbledhës në fund të një njësie, kapitulli, si dhe mund të shoqërojnë një raport të shkruar si pjesë e një projekti të madh. Nëse prezantimi bëhet për një çështje të gjerë, ajo mund të ndahet në nënçështje me grupe brenda klasës. Në këtë mënyrë, mësuesi mund të përdorë vlerësimet sipas grupeve. *Për shembull, në rast se tema që trajtohet është “burimet natyrore”, ajo mund të ndahet në një sërë nënçështjesh, duke i dhënë çdo grupi fushën e tij të ekspertizës. Për shembull, disa nënçështje mund të jenë: llojet e burimeve natyrore; dobia e burimeve natyrore; masat që mund të merren për mbrojtjen dhe ruajtjen e burimeve natyrore.* Këto prezantime mund të jenë pjesë e portofolit të nxënësit, në formë të shkruar ose elektronike.

Mjaft të efektshme për matjen e rezultateve të arritjeve të nxënësve janë edhe *testimet*, të cilat mund të bëhen në fund të kapitujve, semestrit ose vitit shkollor. Kjo kategori përfshin ato teknika vlerësimi, të cilat përdoren në situata të strukturuar për të matur njohuritë e nxënësve. Testet janë pjesë e rëndësishme e vlerësimit të njohurive të nxënësve. Pyetjet e formuluar si duhet kanë rëndësi të veçantë për mësuesin dhe vlerësimin efektiv.

Përcaktimi i blloqeve të përmbajtjeve lëndore që do të kontrollohen, sasia dhe niveli taksonomik i pyetjeve, sistemi i pikëzimit dhe mënyra e konvertimit në notë për çdo test vendosen nga mësuesit.

7. OBJEKTIVAT SIPAS LINJAVE/NËNLINJAVE SIPAS KLASAVE

<p><u>KLASA 7</u></p> <p>35 javë x 2 orë/javë = 70 orë</p>
--

<p>LINJA: MJETET GJEOGRAFIKE DHE VENDNDODHJA</p> <p>Orë të sugjeruara: 19 orë</p>		
<p>Përshkrimi i linjës: Kjo linjë i prezanton nxënësit me shkencën e Gjeografisë. Ata mësojnë të përdorin pesë konceptet bazë të Gjeografisë (vendndodhja/vendi, mjedisi, rajoni, ndërveprimi, zhvillimi) gjatë kërkimeve të tyre. Linja synon të zhvillojë te nxënësit aftësitë bazë të kërkimit gjeografik, përmes njohjes dhe përdorimit të elementeve fillestare të metodave shkencore të kërkimit, si dhe mjeteve gjeografike që shërbejnë për realizimin e tij. Gjithashtu, kjo linjë synon të ngjallë te nxënësit kuriozitetin dhe interesin për karrierën që lidhet me këtë fushë studimi.</p>		
Nënlinja/blloku tematik	Objektivat	Terma/koncepte kyçe
<p>Hyrje në gjeografi (9 orë)</p>	<p>Nxënësit duhet të jenë të aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të përshkruajnë gjeografinë si shkencë dhe objektin e saj të studimit; • të tregojnë rëndësinë e studimit të gjeografisë; • të evidentojnë lidhjet e gjeografisë me shkencat e tjera; • të identifikojnë disiplinat (degët) e 	<ul style="list-style-type: none"> • Shkenca e gjeografisë • Degët e gjeografisë • Kërkimi gjeografik • Pesë temat e gjeografisë (vendndodhja/vendi, mjedisi, rajoni, ndërveprimi/ lidhja

	<p>gjeografisë, duke theksuar ndërlihdjen midis aspektit fizik e human në studimin e gjeografisë;</p> <ul style="list-style-type: none"> • të tregojnë konceptet bazë të kërkimit gjeografik bazuar në pesë temat e saj: vendndodhja/vendi, mjedisi, rajoni, ndërveprimi/ lidhja njeri-mjedis, lëvizja; • të renditin metodat shkencore që përdoren në kërkimet gjeografike (metoda e vrojtimit, e parashikimit, eksperimentale, e krahasimit, statistikore etj.); • të përshkruajnë profesionin e gjeografit dhe rolin që luan ai në studimet gjeografike; • të renditin mjetet gjeografike që përdoren në studimin e gjeografisë (hartat, atlasat, busulla, fotografitë ajrore, imazhet satelitore etj.); • të përshkruajnë historinë e zhvillimit të gjeografisë, shkaqet që i shtynë njerëzit të zbulonin vendet e tjera; • të identifikojnë ngjarjet më të rëndësishme të zbulimeve gjeografike. 	<p>njeri-mjedis, lëvizja)</p> <ul style="list-style-type: none"> • Metodatat e kërkimit gjeografik • Profesionin e gjeografit • Mjetet gjeografike • Zbulimet gjeografike
--	---	---

	<p><i>Veprimtari praktike të sugjeruara¹:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Si t'i përdorim mjetet e gjeografisë.</i> 	
<p>Hartat gjeografike</p> <p>(10 orë)</p>	<ul style="list-style-type: none"> • të përshkruajnë hartat si paraqitje grafike e Tokës; • të krahasojnë planin me hartën dhe tregojnë ngjashmëritë dhe ndryshimet; • të tregojnë llojet e ndryshme të hartave dhe përdorimet e tyre; • të përshkruajnë elementet gjeografike të një harte dhe shkallën e hartës; • të përdorin gjatësinë dhe gjerësinë gjeografike për të përcaktuar vendndodhjen; • të vlerësojnë rëndësinë e përdorimit të hartave në jetën e përditshme. <p><i>Veprimtari praktike të sugjeruara:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Ushtrime për përcaktimin e shkallës së hartës.</i> • <i>Ushtrime për gjetjen e koordinatave gjeografike të një vendi.</i> 	<ul style="list-style-type: none"> • Harta • Plani • Elementet gjeografike të hartës • Shkalla e hartës • Koordinatat gjeografike

¹ Veprimtari praktike të sugjeruara janë orë praktike në funksion të përpunimit dhe thellimit të njohurive të reja, si dhe të aftësisimit praktik të nxënësve. Janë *të sugjeruara*, sepse përdoruesit e programit (hartuesit e tekstit dhe mësuesit) mund t'i ndryshojnë këto veprimtari të sugjeruara, në funksion të nevojave të përpunimit të lëndës.

LINJA: SISTEMET FIZIKE**Orë të sugjeruara: 47 orë**

Përshkrimi i linjës: Përmes kësaj linje nxënësit prezantohen me Tokën si planet dhe lëvizjet e saj, veçoritë e përbërësve të gjeosistemit, lidhjen dhe bashkëveprimin ndërmjet tyre, si dhe pasojat e këtij bashkëveprimi. Nxënësit kuptojnë dhe interpretojnë marrëdhënien e litosferës, hidrosferës, atmosferës dhe biosferës, forcat e brendshme dhe të jashtme dhe veprimtarinë e tyre. Linja synon zhvillimin e aftësive të menduarit kritik, të aftësive hulumtuese, aftësive të grumbullimit, të përpunimit dhe prezantimit të informacionit përmes realizimit të detyrave ose veprimtarive të ndryshme. Nxënësit kryejnë vëzhgime në terren lidhur me parashikimin e motit, reshjet, erërat, veprimtarinë e lumenjve, tokat, bimësinë etj. Ata punojnë me hartën dhe me burime të tjera gjeografike, si: atlase, modele, vizatime, skica, diagrame etj.

Nënlinja/blloku tematik	Objektivat	Terma/koncepte kyçe
Toka, planeti ynë (6 orë)	Nxënësit duhet të jenë të aftë: <ul style="list-style-type: none"> • të përshkruajnë formën e Tokës, përmasat e saj dhe rëndësinë e tyre; • të tregojnë pozicionin e Tokës në sistemin diellor; • të identifikojnë provat që tregojnë se Toka rrotullohet rreth boshtit të saj; • të shpjegojnë pasojat e rrotullimit të Tokës rreth boshtit; • të interpretojnë lëvizjen e Tokës rreth Diellit dhe pasojat e kësaj lëvizje; • të përshkruajnë pozicionin e Tokës kundrejt Diellit në ditët e ekuinokseve dhe solsticeve. 	<ul style="list-style-type: none"> • Toka • Forma e Tokës • Përmasat e Tokës • Pozicioni i Tokës • Sistemi diellor • Dielli • Rrotullim i Tokës rreth vetes • Dita, nata • Rrotullim i Tokës rreth Diellit • Solsticet, ekuinokset • Stinët

	<p><i>Veprimtari praktike</i> <i>të sugjeruara:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Skicimi i Tokës në sistemin diellor dhe rrotullimet e saj; ose ndërtim i tij me materiale të ndryshme.</i> 	
<p>Atmosfera (14 orë)</p>	<ul style="list-style-type: none"> • të tregojnë përbërjen e atmosferës, duke dhënë karakteristikat më kryesore të shtresave të saj; • të formulojnë konceptin mbi rrezatimin diellor; • të evidentojnë brezat e nxehtësisë dhe rëndësinë e rrezatimit diellor, si rrezatimi bazë për planetin tonë; • të interpretojnë ndryshimin e temperaturës në kohë (ditore e vjetore), në hapësirë (vertikal e horizontal), faktorët që ndikojnë në të; • të tregojnë shpërndarjen e temperaturës së ajrit në hartën e izotermave; • të formulojnë konceptin lagështirë e ajrit; • të përshkruajnë procesin e kondensimit të avujve të ujit (formimi i vesës, i mjegullës, i brymës edhe i reve); • të tregojnë kushtet e formimit të llojeve të ndryshme të reshjeve, shpërndarjen gjeografike të tyre; • të vlerësojnë rëndësinë e reshjeve dhe pasojat e tyre; 	<ul style="list-style-type: none"> • Atmosfera • Përbërja, shtresat • Rrezatimi diellor • Temperatura • Izotermat • Lagështira e ajrit • Kondensimi • Vesa, bryma, mjegulla, retë • Reshjet, regjimi, shpërndarja gjeografike • Shtypja atmosferike, shpërndarja gjeografike, izobaret • Erërat, drejtimi, shpejtësia, llojet e erërave, veprimtaria e erës • Moti, parashikimi • Klima, brezat klimatikë • Ndërvarësia njeri-

	<ul style="list-style-type: none"> • të japin kuptimin e shtypjes atmosferike; • të tregojnë ndryshimet e saj në hapësirë dhe në kohë; • të identifikojnë faktorët kryesorë që përcaktojnë veçoritë e erës (drejtimi dhe shpejtësia); • të tregojnë llojet kryesore të erërave; • të identifikojnë pasojat e veprimtarisë së erës dhe format e relievit që krijohen; • të formulojnë konceptet mot dhe klimë, dhe të bëjnë dallimin midis tyre; • të identifikojnë faktorët që ndikojnë në formimin e klimës; • të tregojnë brezat klimatikë nga ekuatori në pole; • të listojnë instrumentet që përdoren për matjen e temperaturës së ajrit, shtypjes atmosferike, lagështirës dhe përcaktimin e drejtimit të erës; • të vlerësojnë rëndësinë e klimës për jetën dhe proceset në Tokë dhe rolin e veprimtarisë njerëzore. <p><i>Veprimtari praktike</i></p> <p><i>të sugjeruara:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Njohja dhe përdorimi i hartës së izotermave dhe izobareve;</i> • <i>Parashikimi i motit.</i> 	<p>klimë</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rëndësia e klimës
--	--	--

<p>Hidrosfera</p> <p>(13 orë)</p>	<ul style="list-style-type: none"> • të përkufizojnë hidrosferën; • të listojnë përbërësit e hidrosferës; • të përshkruajnë lidhjen e hidrosferës me litosferën, atmosferën, biosferën; • të interpretojnë qarkullimin e ujit në natyrë; • të përshkruajnë origjinën e ujit të oqeanit botëror; • të identifikojnë veçoritë e ujit të deteve dhe oqeaneve (temperatura, kripësia, dendësia); • të përcaktojnë format e lëvizjeve të ujërave oqeanike; • të përshkruajnë mënyrën e formimit të valëve detare dhe të përmendin shkaqet e formimit të tyre; • të përshkruajnë formimin e baticave dhe zbaticave dhe pasojat e tyre; • të vlerësojnë rëndësinë e baticave e zbaticave dhe shfrytëzimin e energjisë së tyre nga njeriu; • të përmendin veçoritë kryesore të rrymave oqeanike dhe llojet kryesore të tyre; • të identifikojnë në hartë rrymat kryesore, si: Golfstrimi, Labradori etj.; • të vlerësojnë rëndësinë e rrymave oqeanike për klimën në Tokë; • të përkufizojnë lumin dhe elementet përbërëse të tij (burimi, grykëderdhja, 	<ul style="list-style-type: none"> • Hidrosfera • Qarkullimi i ujit në natyrë; • Oqeanet • Detet • Përbërja, vetitë e ujit të detit; • Lëvizja e ujërave oqeanike (valët detare, baticat dhe zbaticat, rrymat oqeanike); • Ujërat nëntokësore, burimet • Lumenjtë • Pjesët e lumenjve • Regjimi i lumenjve • Klasifikimi i lumenjve • Liqenet • Akullnajat • Veprimtaria e forcave të jashtme
--	--	---

	<p>shtrati i lumit, degët e lumit, pellgu ujëmbledhës, vija ujëndarëse);</p> <ul style="list-style-type: none"> • të identifikojnë llojet e lumenjve (sipas relievit që përshkojnë, nga regjimi i ushqimit); • të përkufizojnë liqenin; • të përshkruajnë tipat e ndryshëm të liqeneve sipas origjinës së formimit të tyre (shoqëruar me shembuj); • të dallojnë tipat e ndryshëm të ujërave nëntokësore dhe mënyrën e formimit të tyre; • të vlerësojnë shfrytëzimin e ujërave nëntokësore nëpërmjet hapjes së puseve dhe rëndësinë e burimeve; • të tregojnë ç’është bora e përhershme, si dhe ku formohet zakonisht; • të përshkruajnë akullnajat, llojet, pasojat e veprimtarisë së tyre. <p><i>Veprimtari praktike</i></p> <p><i>të sugjeruara:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Plotësimi në hartën skicë i oqeaneve dhe rrymave kryesore.</i> • <i>Plotësimi në hartën skicë i lumenjve dhe liqeneve kryesore në botë.</i> 	
<p>Litosfera (12 orë)</p>	<ul style="list-style-type: none"> • të përshkruajnë ndërtimin e brendshëm të Tokës dhe veçoritë kryesore për secilën shtresë; • të përshkruajnë formimin e 	<ul style="list-style-type: none"> • Litosfera • Ndërtimi i brendshëm i Tokës • Formimi i

	<p>kontinenteve si pasojë e lëvizjes së pllakave tektonike;</p> <ul style="list-style-type: none"> • të përkufizojnë format kryesore të relievit të kontinenteve (mal, kodër, fushë, pllajë, rrafshnaltë); • të dallojnë lartësinë absolute dhe lartësinë relative; • të përshkruajnë paraqitjen e relievit në hartë nëpërmjet izohipseve; • të përshkruajnë llojet kryesore të shkëmbinjve; • të tregojnë ç’janë fosilet; • të përshkruajnë procesin e formimit të dheut; • të identifikojnë faktorët kryesorë që ndikojnë në formimin e dherave; • të përshkruajnë dukurinë e formimit të tërmeteve; • të identifikojnë pasojat e tërmeteve; • të përcaktojnë në hartë shpërndarjen gjeografike të tërmeteve; • të listojnë disa nga tërmetet më të mëdha që kanë ndodhur në botë dhe vendin tonë, si dhe pasojat e tyre; • të përshkruajnë vullkanin, pjesët përbërëse të tij dhe produktet vullkanike; • të identifikojnë në hartë zonat kryesore vullkanike. 	<p>kontinenteve</p> <ul style="list-style-type: none"> • Pllakat tektonike • Relievi i kontinenteve • Lartësia absolute dhe lartësia relative • Shkëmbinjte • Llojet e shkëmbinjve • Fosile • Dherat • Tipat e dherave • Vullkanet • Pjesët e vullkanit • Produktet vullkanike • Shpërndarja gjeografike e vullkaneve • Tërmetet • Epiqendra • Hipoqendra • Valët sizmike • Shpërndarja gjeografike e tërmeteve
--	--	--

	<p>Veprimtari praktike të sugjeruara:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Plotësimi në hartën-skicë i formave të relievit.</i> • <i>Plotësimi në hartën-skicë i zonave sizmike dhe vullkanike.</i> 	
<p>Biosfera (2 orë)</p>	<ul style="list-style-type: none"> • të identifikojnë faktorët që ndikojnë në shpërndarjen e pabarabartë të botës bimore e shtazore sipas brezave të nxehtësisë. 	<ul style="list-style-type: none"> • Flora • Fauna • Shpërndarja e pabarabartë e florës dhe faunës
<p>LINJA: NDËRVEPRIMI NJERI/MJEDIS</p> <p>Orë të sugjeruara: 4 orë</p>		
